



## Thirrje për shprehje interesi për ngritjen e Grupit të Kolegëve

### Trualli

Shëndet për të Gjithë (HAP) është një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe zbatohet në Shqipëri që nga viti 2015. Qëllimi kryesor i projektit është të mundësojë që popullsia shqiptare të gëzojë shëndet të mirë falë shërbimeve të përmirësuara të kujdesit shëndetësor parësor. Që nga 1 prill 2019 HAP-i ka hyrë në fazën e dytë që zbatohet nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale në Bazel, nëpërmjet Qendrës HAP në Shqipëri.

HAP në fazën e dytë (2019-2023) vazhdon të ketë si një ndër strategjitë e tij mbështetjen për të përmirësuar cilësinë e kujdesit shëndetësor parësor nëpërmjet aftësisë së ekipeve të mjekësisë së familjes për ofrimin e shërbimeve që parashikon Paketa e shërbimeve shëndetësore në KSHP publik (VKM. Nr.101, datë 4.02.2015), në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të Shërbimeve të KSHP-së në Shqipëri 2020-2025 (VKM. Nr.405, datë 20.05.2020).

Një prej përjasjeve të suksesshme të HAP-it deri më tani lidhur me aktivitet e edukimit në vazhdim, është prezantimi dhe ngritja e Grupeve të Kolegëve (GK) si një formë e re e Edukimit të Vazhdueshëm për profesionistët e kujdesit shëndetësor parësor. Grupet e Kolegëve si një formë e Edukimit në Vazhdim të profesionistëve shëndetësorë njihet nga QKEV-ja si “Grup rishikimi” sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 22.9.2015 (ndryshuar me VKM nr.304, datë 5.4.2017; nr.418, datë 4.7.2018) “Për përcaktimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”.

Që prej vitit 2015, HAP-i ka mbështetur ngritjen dhe funksionimin e Grupeve të Kolegëve në qendrat shëndetësore në qarkun Dibër dhe Fier.

### Informacion mbi Grupet e Kolegëve

Grupet e Kolegëve janë një mënyrë trajnimi në vendin e punës nëpërmjet të cilit, mjekë familje dhe infermierë të së njëjtës qendër shëndetësore, por jo vetëm, takohen sipas një plani të paracaktuar për të diskutuar mbi çështje të ndryshme të praktikës së tyre klinike dhe menaxheriale. GK në qarkun Fier dhe Dibër kanë dëshmuar një potencial për ndikim të drejtëpërdrejtë në praktikën e përditshme të ekipit të mjekësisë së familjes dhe të krijimit të një ambjenti nxitës për edukimin e vazhdueshëm të mjekëve dhe infermierëve të familjes në qendrën shëndetësore (Studimi “Vlerësimi i Grupit të Kolegëve si një mjet i Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor (EVM) për ekipin e KSHP-së” 2019. Shkarkoni përmbledhjen e raportit duke klikuar këtu <https://bit.ly/30x7DVj>).

Grupi i kolegëve mund të përbëhet nga mjekë familje, nga infermierë ose edhe nga të dy së bashku, mjekë dhe infermierë, kur çështja që do të adresojë grupi në takimet e tij është në interes dhe në përgjigje të një nevoje të përbashkët të mjekëve dhe infermierëve.



HAP në bashkëpunim me QKEV-në bazuar në eksperiencën me GK në qarkun Dibër dhe Fier ka hartuar “Udhëzuesin për ngritjen dhe funksionimin e Grupeve të Kolegëve” që mundëson zbatimin e kësaj forme të edukimit në vazhdim edhe nga profesionistë të kujdesit shëndetësor parësor në qarqet e tjera përpos Fierit dhe Dibrës. Për të shkarkuar Udhëzuesin, klikoni këtu: <https://bit.ly/30w6HQV>

Për të mësuar më shumë mbi vlerën edukuese të GK nëpërmjet dëshmime të mjekëve dhe infermierëve të cilët janë facilitatorë/organizues të Grupeve të Kolegëve në qarqet Dibër dhe Fier, lutemi të shihni videon në këtë link: <https://bit.ly/3ftay5C>

Për shtrirjen e Grupeve të Kolegëve në nivel kombëtar, HAP-i po planifikon ofrimin e mbështetjes për ekipet e KSHP-së përtej qarqeve Dibër dhe Fier. Në këtë kuadër, HAP fton ekipet e qendrave të KSHP-së nga e gjithë Shqipëria, të paraqesin interesin për të ngritur Grupin e Kolegëve në qendrën e tyre shëndetësore.

### **Mbështetja e Projektit Shëndet për të Gjithë**

Me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e ekipeve të KSHP-së në ngritjen dhe funksionimin e Grupeve të Kolegëve si një mjet efektiv i edukimit në vazhdim në vendin e punës, HAP angazhohet të mbështesë ekipet e QSH-ve në përgjigje të interesit të tyre në ngritjen dhe funksionimin e GK, me:

#### *Faza 1:*

Seanca trajnimi të Facilitatorëve të Grupeve lidhur me ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Kolegëve

#### *Faza 2:*

Zgjidhje/komunikim online për mbështetjen në vijimësi të facilitatorëve të grupeve gjatë procesit të funksionimit të GK,

Pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mbarëvajtjen e takimeve të Grupit dhe të komunikimit efektiv me QKEV-në, për grupet që do të kenë demonstruar progres të dukshëm në aktivitetet e tyre.

### **Udhëzime për shprehjen e interesit**

Interesi mund të shprehet në emër të një QSH-je nga një mjek familje, infermjere familje ose të dy së bashku kur dëshirojnë të luajnë rolin e facilitatorit/rëve të Grupit të Kolegëve në Qendrën e tyre, duke plotësuar [formularin bashkangjitur](#). Pavarësisht se shprehja e interesit për t'u bërë pjesë e kësaj mbështetjeje është një mjek apo një infermjere familje, Drejtori i QSH-së përkatëse duhet të vihet në dijeni dhe të jetë dakord për këtë formë të edukimit në vazhdim në qendrën e tyre.

Nga një QSH duhet të vijë **vetëm një shprehje interesi** nga një individ: Mjek Familje ose infermier Familje ose një dyshe MF/Infermier nga një QSH.



Përpara dërgimit të formularit për shprehje interesi, këshillojmë:

1. Njohjen me “Udhëzuesin për ngritjen dhe funksionimin e Grupeve të Kolegëve’ (<https://bit.ly/30w6HQV>)
2. Pjesëmarrjen në Takimet orientuese online që do të zhvillojë HAP-i me pyetje dhe përgjigje në **1 javë pas shpalljes së thirrjes**. Për këtë të interesuarit duhet të dërgojnë një email për të marrë pjesë në këto Takime në adresën [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al) deri më **12 gusht**. Të dhënat për datën, orën e takimit si dhe kredencialet për të hyrë në takim, do tu bëhen të ditura nga HAP-i.

#### **Afati për shprehjen e interesit**

Plotësimi dhe dërgimi i formularit *bashkëngjitur* për shprehje interesi për ngritjen e GK, në adresën [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al), brenda datës **31 gusht 2020**.



<b>Të dhëna për facilitatorin/ët* dhe QSH-në</b>	
Emër Mbiemër	
Profesioni	
Pozicioni	
Qendra Shëndetësore	
Numri i mjekëve në QSH	
Numri i infermierëve në QSH	
Bashkia	
NjVKSH	
Telefon/E-mail	
<b>Motivimi</b>	
<i>Ju lutem shpjegoni pse dëshironi të ngrini një Grup Kolegësh në qendrën tuaj shëndetësore.</i>	
<i>Përmbledhje e CV-së (jo më shumë se 250 fjalë)</i>	

---

\*Kur janë më shumë se dy vetë, kërkesa duhet të përfshijë të dhënat e të dy personave.